



Prokurimi publik në kohë pandemie

Raport për prokurimet në sektorin
e shëndetësisë publike

Prishtinë, shtator 2022





Instituti Demokratik I Kosovës është degë e
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e
zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse
dhe luftës kundër korrupsion përmes
promovimit të transparencës,
llogaridhënies dhe integritetit në të
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

Disclaimer:

Opinionet e shprehura në këtë botim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Balkan Trust for Democracy - Fondit Gjerman Marshall të SHBA-së, USAID-it apo Geverisë së SHBA-së.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 239,
10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +381 (0)38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Web: www.kdi-kosova.org

Layout and design: **envinion**

PËRMBAJTJA

Lista e Shkurtesave.	6
Hyrje	8
Metodologjia	9
Përmbledhje ekzekutive.	10
Gjetjet kryesore	11
Analiza	12
a) Analiza e Planifikimit të Prokurimit	12
b) Analiza e Njoftimeve Paraprake	13
c) Kërkesa për Autorizim Marketing në Dosje të Tenderit	14
d) Efikasiteti i prokurimeve	15
e) Analiza e procedurave të prokurimit / Ekonomiciteti i shpenzimeve	18
f) Mbikëqyrja e shpenzimeve publike dhe llogaridhënia	26
Rekomandime	27



Lista e Shkurtesave

AK	Autoriteti Kontraktues
BE	Bashkimi European
DT	Dosja e Tenderit
FSSh	Fondi i Sigurimit Shëndetësor
KDI	Instituti Demokratik i Kosovës
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LEB	Lista Esenciale e Barnave
LOT	Një numër njësisish të një artikulli, një artikull të vetëm, ose një paketë artikujsh të ofruara si një artikull
LPP	Ligji për Prokurimin Publik
MSh	Ministria e Shëndetësisë
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OE	Operatori Ekonomik
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
SHSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
TI	TransparencyInternational
UA	Udhëzim Administrativ
UNOPS	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbimet e Projektit
ZP	Zyrtar i Prokurimit



Shpenzoni çfarë mundeni, por mbani faturat!"¹

Kristalina Georgieva,
Drejtoreshë e Fondit Monetar Ndërkombëtar
2020, në fillimin e pandemisë COVID-19

¹ Një thirrje që nënkupton, shpenzoni aq sa mundeni të shpëtoni jetë, por me transparencë dhe llogaridhënie



Hyrje

Me të hyrë në vitin 2020, i gjithë globi u trondit nga një rrezik i paparashikuar, rreziku për jetë. Ballafaqimi me këtë fatkeqësi madhore nxjerri në pah çështje të reja, të papara dhe mjaft komplekse në politikat publike. Limitimet në furnizim me barna dhe materiale, pajisje, teste, vakcina, kapacitetet e spitaleve, politikat kufizuese dhe parandaluese, etj., janë vetë, disa nga problemet e shumta me të cilat u ballafaquan qeveritë e gjithë globit, madje edhe ato me politika shëndetësore mjaft të zhvilluara dhe avancuara. Forcat madhore si fatkeqësitë natyrore, luftërat, trazirat, epidemitë etj., luajnë një rol të rëndësishëm në funksionimin e zinxhirit të furnizimeve të ndryshme e sidomos furnizimeve medicinale. Urgjenca, kërkesa dhe mungesat po bënin presion të paparë në zinxhirët e furnizimit global. Këto urgjenca në këtë fatkeqësi globale, në fakt ishin favorizuese vetëm për korrupsionin! Raporte² dhe analiza³ nga më të ndryshmet në nivel botëror shpërfaqin shqetësime serioze, ndërsa qytetarët gjatë kësaj periudhe gati dy vjeçare, u prekën nga “dy pandemi”, COVID-19 dhe korrupsionin në prokurimet publike⁴, e sidomos në sektorin e shëndetësisë⁵.

Qëllimi i këtij raporti është të analizoj dhe ilustroj gjendjen me shpenzimet publike të realizuara nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës dhe Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës në përgjigje të COVID-19. Analiza ka për qëllim të trajtoj integritetin, transparencën dhe sfidat në procesin e prokurimit publik të realizuar nga këto institucione në përgjigje të ballafaqimit me pandeminë. Përmes ekspozimit të sfidave, gjetjeve dhe keqpërdorimeve të evidentuara gjatë monitorimit të prokurimit publik në MSH dhe SHS-KUK dhe përmes përfshirjes së gjetjeve të tilla në debatin parlamentar dhe publik, KDI synon t’ a ndikojë vendimmarrjen publike, në mënyre që ajo të t’i përgjigjet nevojave të qytetarëve dhe të mos shtrembërohet nga interesat private.

² Korrupsioni dhe pandemia Covid-19, [World Justice Project](#)

³ Korrupsioni dhe rryshfeti në vazhden e pandemisë COVID-19, Csonka, Peter & Salazar, Lorenzo, Eurocrim, issue 2/2021, pp 111-114

⁴ Beteja e sektorit publik kundër dy pandemieve: COVID-19 dhe korrupsionin në prokurimin publik, Bleetman, Rachel - Research and Policy Manager, ACCA, 2022 published in International Federation of Accountants

⁵ COVID-19 ka krijuar kushte në të cilat mund të luajë korrupsioni në prokurimin shëndetësor. Ja se si do të ndihmonë kontrata e hapur, [Transparency International UK, 2022](#)

⁶ [Tenderët në pandemi, KDI 2020](#)



Metodologjia

KDI gjatë këtij hulumtimi ka shfrytëzuar metodologji mikse që përfshin shqyrtimin e studimeve të ngjashme, analizën e dokumentacionit dhe legjislacionit të fuqi që rregullon prokurimin publik, monitorimin direkt të prokurimeve në platformën E-prokurimi, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare dhe intervistat e takimet me akterët e përfshirë dhe përfituesit përfundimtarë.

Analiza e procesit të prokurimit është e bazuar në rekomandimet e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), të adaptuara nga Transparency International, që trajtojnë metodologjinë për vlerësimin e performancës së sistemeve të prokurimit, parimet e integritetit në prokurim publik dhe parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik.

Këto metodologji janë zhvilluar me qëllim të matjes së katër shtyllave esenciale në shpenzimin e drejtë të parasë publike përmes prokurimit publik si (1) bazën ligjore dhe ligjshmërinë, (2) organizimin institucional dhe kapacitetet menaxhuese, (3) zhvillimet e prokurimeve dhe praktikat e tregut, dhe (4) llogaridhënia, integriteti dhe transparenca institucionale.



Përmbledhje ekzekutive

Raporti i monitorimit të prokurimeve publike në ballafaqimin me pandeminë COVID-19 vë në pah mangësi, sfida dhe probleme të ndryshme në shpenzimet e realizuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës.

Sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë, gjatë vitit 2020, Kosova (përfshirë të gjitha organizatat buxhetore të aplikueshme) kishte shpenzuar rreth 273 milion euro për nevojat të shëndetësisë, një rritje kjo prej mbi 23% kundrejt një viti më parë (nga 221.29 milion euro në 2019 në 272.79 milion euro në 2020)⁷.

Për të përmbushur nevojat dhe kërkesat që po i diktonte pandemia, Ministria e Shëndetësisë kishte kërkuar mbështetje shtesë financiare nga Qeveria dhe donatorët.⁸ Përkundër rritjeve të vazhdueshme të buxhetit për sektorin e shëndetësisë, auditimi i pasqyrave financiare të Ministrisë së Shëndetësisë nxjerr në pah probleme serioze në menaxhimin e parasë publike, ku kjo ministri gjatë vitit 2021 kishte shpenzuar vetëm 54% të buxhetit të saj, e që ishte një ulje prej 9% kundrejt shpenzimeve të një viti paraprak⁹. Një theks i veçantë bie mbi shpenzimet e financimit përmes huamarrjes, ku në dy linja të financimit, kjo ministri kishte shpenzuar vetëm rreth 39% të këtyre mjeteve¹⁰, për të cilat takspaguesit e Kosovës paguanjné interes të huamarrjes, ndërkohë që në vazhdimësi u është dashur të sigurojnë vetë barnat e nevojshme për trajtim shëndetësor, përfshirë trajtimin për Covid-19¹¹.

Raporti në vazhdim identifikon disa fusha të këtyre shpenzimeve me probleme të theksuara, të cilat përveç që kanë ndikuar në efikasitetin e prokurimeve, ato po ashtu nuk kanë arritur ekonomikitetin e tyre duke paguar shuma nga 3 deri në 300% më të larta se vet kontratat e këtyre institucioneve.

Disa nga problemet sistematike me të cilat është shoqëruar prokurimi publik në sektorin e shëndetësisë në Kosovë janë: 1) planifikimet e dobëta dhe jo adekuate kundrejt nevojave të kohës; 2) vendime të pambështetura dhe arsyeuara të cilat kanë shkaktuar vonesa dhe humbje të parasë publike; 3) mos respektim i dispozitave ligjore të prokurimit publik lidhur me mënyrën e njoftimeve të prokurimit; 4) aplikimi jo standard i kriterëve, veçmas të përshtatshmërisë, për furnizime të njëjta apo të ngjashme; 5) qasja jo standarde ndaj ankesave të parashtruara nga operatorët ekonomik në OSHP; 6) Kontroll i dobët në menaxhimin e kontratave; si dhe 7) mos respektimi i ligjit për COVID-19 nga Qeveria e Kosovës, respektivisht Ministria e Shëndetësisë.

Përderisa në fillim të pandemisë janë përdorur procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë, për shkak të urgjencës së madhe të krijuar, më vonë institucionet kanë vazhduar me procedura të hapura.

Sa i përket vaksinimit kundër COVID 19, me gjithë përpjekjet e mëdha, Kosova vetëm në prill 2021 ka filluar të sigurojë vaksinën përmes blerjeve dhe donacioneve. Kosova ishte vendi i fundit në Evropë që filloi me fushatën e vaksinave, ndërsa çmimi i vaksinave të blera nga kompania Pfizer vazhdon të mbetet ndërkohë që blerja është realizuar jashtë Ligjit për Prokurimin Publik.

⁷ Ibid

⁸ Raporti i llogarive kombëtare të shëndetësisë 2020, Ministria e Shëndetësisë

⁹ Raporti i Auditimit të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2021, fq.17, Zyra Kombëtare e Auditimit 2022

¹⁰ Ibid

¹¹ Në QKUK mungojné barnat për trajtimin e COVID-19, Kallxo.com 30 Gusht 2021

Gjetjet kryesore

- SHSKUK kishte mangësi në hartimin e Planit të Prokurimit dhe përdorimin e Njoftimit Paraprak. Plani i Prokurimit nuk është bërë sipas kërkesave të Ligjit për Prokurim Publik. Plani i Prokurimit për vitin 2022 (dhe për vitet e mëhershme) është një dokument i formatit MS Excel dhe përmban vetëm 9 rreshta, ndërsa të gjitha furnizimet janë grumbulluar në një vend;
- I gjithë furnizimi me barna kundër COVID 19 është grumbulluar në një rresht të vetëm, vlera e parashikuar është mbi 21 milionë euro;
- Njoftimi Paraprak për të gjitha aktivitetet e prokurimit është bërë në një vend. Mirëpo pastaj, SHSKUK ka publikuar tenderët veç e veç. Sipas RRUOPP, pasi tenderët e publikuar janë të ndarë, atëherë do të duhej të kishte Njoftim Paraprak për secilin prej tyre, në mënyrë që shkurtimi i afatit të ofertimit të ketë bazë ligjore;
- Një opinion ligjor nga Ministria e Shëndetësisë ka bërë që në dosje të tenderit mos të lejohet përdorimi i Udhëzimit Administrativ 02/2014 që lejon importin e barnave që nuk kanë Autorizim Marketing për Kosovë, me kushtin që ato të kenë AM në një vend të Bashkimit Evropian për produktet të cilat kanë paralele. Përderisa MSH ka ndaluar përdorimin e UA në tenderët e saj, SHSKUK vazhdon që të lejojë atë. Mos komunikimi ndërmjet dy institucioneve kryesore të fushës së shëndetësisë ka bërë që njëra të blejë produkte edhe kur nuk kanë AM të regjistruar në Kosovë, e tjetra kërkon që vetëm me AM mund të ofertohej. Kjo ka shkaktuar konfuzion dhe paqartësi në krahun e ofertës, por edhe standard të dyfishtë në prokurime të shëndetësisë të nivelit qendror
- Qytetarët janë detyruar të blejnë në masë të konsiderueshme barnat kundër COVID me buxhet vetanak. Një prej barnave që është blerë më së shpeshti nga qytetarët është Remdesivir. MSH kanë dështuar të sigurojnë me kohë dhe sasi të mjaftueshme këtë medikament, ndërsa qytetarët janë detyruar të shpenzojnë për këtë bar qindra euro. Remdesivir është blerë një vit pas kërkesës për blerje të bërë nga njëra kërkuese në

MSH. Ndërsa në Spitalin e Pejës dhe Prizrenit, produkti Imipenem + Cilastatine plv per sol për inj 500mg është blerë për një kohë nga vetë qytetarët edhe pse SHSKUK kishte kontratë aktive;

- UNOPS, si menaxhuese e fondeve të destinuara për blerjen e produkteve të pandemisë nga kredia e Qeverisë së Kosovës me Bankën Botërore ka dështuar disa herë që të arrijë vlerën më të mirë për paranë e shpenzuar. Në katër raste produktet janë blerë më shtrenjtë nga UNOPS sesa nga SHSKUK dhe MSH. UNOPS gjithashtu ka shpërblyer me kontrata kompaninë e cila ka qenë në Listë të Zezë. E njëjta kompani nuk ka mundur të fitojë kontrata gjatë asaj periudhe përmes prokurimit publik. UNOPS ka mungesë të theksuar të transparencës, ku vetëm disa të dhëna rreth kontratës publikohen, por jo edhe kontrata;
- Për tenderin për furnizim me oksigjen, SHSKUK nuk ka lidhur kontratë me OE që kishte ofertuar 10 cent më lirë se kontrata e cila ishte në zbatim, me arsyen se ka rënë kërkesa. Mirëpo vetëm pas dy muajsh me procedurë të negociuar, SHSKUK shpërbleu me kontratë, kompaninë e cila kishte kontratën duke u zbatuar;
- Në maj të vitit 2021, Kosova kishte kontraktuar blerjen e 1.2 milion dozave të vaksinës kundër COVID-19 të kompanisë Pfizer. Ndonse sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për menaxhimin e Financave Publike, çmimi përfundimtar të cilin e paguan qytetari, respektivisht tatimpaguesi i Kosovës, nuk mund të jetë sekret, Ministria e Shëndetësisë ka klasifikuar këtë kontratë si sekrete dhe ende mbahet e fshehur ndaj qytetarëve si nga përmbajtja, po ashtu edhe nga vlera.

Analiza

KDI ka analizuar të gjitha procedurat e prokurimit të publikuara nga MSH dhe SHSKUK në mënyrë që të dihet sa së është vlera totale e kontratave për produkte medicinale për të luftuar Covid-19. Edhe pse ka qenë e vështirë se cili produkt shërben për trajtimin e Covid-19, KDI është bazuar në të dhënat për produkte të cilat janë listuar në Udhërrëfyesin Klinik për Covid-19¹². Kështu që nga fillimi i pandemisë e deri në qershor 2022, këto dy institucione kanë shpenzuar së paku 35 milion euro. Këtu janë përfshirë barnat, veshjet mbrojtëse, maska, dezinfektues, ndërtim, shpenzimet të varrimit për personat e vdekur, etj. Përveç fillimit të pandemisë, në muajt në vijim është përdorur procedura e hapur.

Në këtë shumë nuk janë të përfshira blerjet që janë bërë përmes UNOPS. Një e dhënë shqetësues është numri i mesatar i ofertave të pranuar. Përderisa në Kosovë viteve të fundit, janë mesatarisht pesë ofertues për një tender, në tenderët e këtyre dy institucioneve janë vetëm tre ofertues. Kjo mesatare është më e ulët nëse largohen nga llogaritja tenderët për furnizim me pajisje mbrojtëse. Në atë rast mesatarja është, 2.11 oferta për një tender. Këto të dhëna shpërfaqin mungesën e konkurrencës së mirëfilltë në tenderët e MSH dhe SHSKUK.

a) Analiza e Planifikimit të Prokurimit

Planifikimi i prokurimit është një proces shumë i rëndësishëm për secilin Autoritet Kontraktues. Si hapi i parë në prokurimin publik, planifikimi është determinues edhe i fazave tjera të prokurimit, sepse një planifikim i mirë ndikon në suksesin e AK-së për vitin përkatës, dhe e kundërta një planifikim i dobët sjellë pasoja të paparashikueshme për AK-në. KDI ka analizuar Planin e Prokurimit për SHSKUK dhe MSH për vitin 2022 dhe ka parë dallime të mëdha në mënyrën se si janë hartuar dhe përmbajtjen e tij.

Përderisa MSH ka hartuar një plan mjaft të detajuar të prokurimit, kjo ka ndodhur edhe me SHSKUK. Plani i Prokurimit nuk është sipas kërkesave të Ligjit për Prokurim Publik. Plani i Prokurimit për vitin 2022 (dhe për vitet e mëhershme) përmban vetëm nëntë rreshta në dokumentin e formatit MS Excel e ku janë të grumbulluar të gjitha

furnizimet në një vend. I gjithë furnizimi me barna është grumbulluar në një rresht, e ku vlera është mbi 21 milionë euro. Sasia e dhënë është 211 copë. Kjo sasi nuk ka ndonjë kuptim pasi nuk janë të listuar se cilat barna do të blihen. Pesë aktivitete të prokurimit e kanë sasinë "1", e që lë të kuptohet që fare nuk është llogaritur sasia e parashikuar e këtyre furnizimeve. Ndërsa shërbimet nuk janë listuar fare, edhe pse gjatë vitit 2021, SHSKUK ka pasur disa kontrata të shërbimeve. KDI gjatë bisedave që ka pasur me zyrtarë të SHSKUK ka konfirmuar se sasia e produkteve që do të blihen nuk dihet gjatë hartimit të Planit të Prokurimit. Sipas LPP, çdo rresht në Planin e Prokurimit duhet të korrespondojë me një aktivitet të prokurimit. Në formën siç është hartuar, është e pamundur të kuptohet se çfarë barna do të blihen gjatë vitit 2022 nga SHSKUK. Sipas Rregullores së Prokurimit Publik¹³ dështimi për ta hartuar Planin e

12 Udhërrëfyesi-Klinik-Menaxhimi-dhe-trajtimi-i-COVID-19.pdf (omk-rks.org)

13 <https://bit.ly/3ec1tTT>

Prokurimit si duhet konsiderohet si keq menaxhim. Plani i Prokurimit i SHSKUK nuk mund të konsiderohet planifikimi i prokurimit pasi nuk përmban të dhëna për aktivitetet e prokurimit që do të publikohen gjatë vitit 2022, por më shumë është një ndarje buxhetore apo përmbledhje se në cilat kategori do të shpenzohen paratë (furnizim, shërbime apo punë)¹⁴. Formatin e Planit të Prokurimit i hartuar nga

SHSKUK është bërë vetëm sa për të plotësuar një kërkesë të Ligjit, por nuk i shërben as SHSKUK si autoritet kontraktues, as operatorëve ekonomik e as palëve të treta të interesuara. Me të dhënat në këtë plan nuk mund të kuptohet fare se çfarë barna ka planifikuar të blejë SHSKUK gjatë vitit 2022.

b) Analiza e Njoftimeve Paraprake

Njoftimi paraprak është një njoftim që mund ta përdorin autoritetet kontraktuese për të shkurtuar afatin kohor për OE për të ofertuar. Njoftimi paraprak përdoret kur AK e di disa muaj më herët se çfare produkte dëshiron të blejë dhe i njofton paraprakisht OE të interesuar se ka ndërmend që pas disa javëve ose muajve që të publikojë një tender.

SHSKUK nuk e ka përdorur këtë procedurë ashtu siç kërkohet me RRUOPP dhe interpretimin nga KRPP në Pyetjet e Shpeshta Nr. 58. KDI ka parë që SHSKUK ka publikuar më 24 janar 2022, Njoftimin Paraprak për tenderin "Furnizim me barna nga LE për nevojat e SHSKUK-së" me numër të prokurimit 00220-22-207-1-1-1. Më 25 shkurt 2022, SHSKUK ka publikuar tenderin "Furnizim me Ceftriaxone nga LE për nevojat e SHSKUK-së" dhe "Furnizim me barna nga Lista e re Esenciale për nevojat e SHSKUK-së" ku është shkurtuar afati për ofertim nga 40 ditë në 24 ditë me arsyen se është publikuar Njoftimi Paraprak. SHSKUK ka publikuar Njoftimin Paraprak për të gjitha prokurimet që do të bëhen gjatë vitit 2022¹⁵.

Pra sipas RRUOPP dhe interpretimit nga KRPP, autoriteti kontraktues mund të përfshijë të gjitha kontratat në Njoftimin Paraprak me kusht që ato të zhvillohen brenda një aktiviteti të prokurimit i cili është i ndarë në lote. Në rastin aktual, SHSKUK ka publikuar tenderët veç e veç, e duke ju referuar Njoftimit Paraprak të publikuar më 24 janar 2022 për shkurtim të afatit kohor për të ofertuar. Sipas RRUOPP, pasi tenderët e publikuar janë të ndarë, atëherë do të duhej të kishte Njoftim Paraprak për secilin prej tyre, në mënyrë që shkurtimi i afatit të ofertimit të ketë bazë ligjore. Analiza ka gjetur se SHSKUK nuk ka vepruar në përputhje me ligjin, pasi tenderi është publikuar më 25 shkurt 2022, pra pas 30 ditësh¹⁶. Mundësia për të shkurtuar afatin në formë të tillë, ku publikohet Njoftimi Paraprak dhe nuk jepen detaje se cilët tenderë do të publikohen në të ardhmen mund të krijojë hapësirë për abuzime. Në fakt të gjithë OE kanë vetëm 24 ditë afat për ofertuar, krahasuar me afatin standard prej 40 ditësh. Kjo mënyrë mund të favorizojë OE të caktuar të cilët i kanë dokumentet e nevojshme për ofertim, dhe mund të krijojë barrierë të hyrjes për kompanitë e reja, të cilave ju nevojitet më shumë kohë.

14 Neni 5.6 i RRUOPP thotë: 5.6 Planifikimi Paraprak i prokurimit do të identifikoj, "në detaje të mjaftueshme", të gjitha furnizimet, shërbime dhe punët që AK parashih të prokuror gjatë vitit të ardhshëm fiskal. Ndërsa neni 5.13 i RRUOPP thotë: 5.13 Për të kryer një planifikim të mirë të prokurimit zyrtarit të prokurimit do ti nevojitet bashkëpunimi i ngushtë me departamentin e buxhetit dhe departamentet tjera. Zyrtari i prokurimit do të takohet me personat përgjegjës për buxhet dhe departamentet që bëjnë kërkesat (përdoruesit) dhe të diskutojë kërkesat e tyre për prokurim dhe buxhetin në disponueshmëri për vitin e ardhshëm dhe do të vendosë cilët artikuj të përfshihen në planifikimin paraprak dhe final të prokurimit.

15 Neni 6.3 i RRUOPP thotë: 6.3 Njoftimi Paraprak përgatitet dhe publikohet për kontratat me vlerë të madhe: • Një kontratë të vetme qoftë ajo furnizim, shërbim apo punë nëse vlera e parashikuar është prej pesë qind mijë (500.000) Euro; ose • Të gjitha kontratat e furnizimeve, shërbimeve apo punëve që së bashku arrijnë vlerën e parashikuar prej pesë qind mijë (500.000) Euro dhe AK vendos të ushtrojë një aktivitet të vetëm të prokurimit duke e ndarë në Pjesë (Lote) homogjene apo heterogjene secilën kontratë. Ndërsa interpretimi i KRPP-së thotë: T'i përfshijë në një Njoftim Paraprak të gjitha kontratat furnizimeve, shërbimeve apo punëve që së bashku arrijnë vlerën e parashikuar prej pesë qind mijë (500.000) Euro dhe AK vendos të ushtrojë një aktivitet prokurimi duke e ndarë në Pjesë (Lote) homogjene apo heterogjene secilën kontratë.

16 RUOPP, neni 6.5, reduktimi i afatit mund të bëhet vetëm nëse Njoftimi Paraprak është publikuar jo më pak se 40 ditë e jo më shumë se 12 muaj para publikimit të Njoftimit për Kontratë.

c) Kërkesa për Autorizim Marketing në Dosje të Tenderit

Çdo produkt medicinal që del në treg duhet të ketë autorizimin për tu shitur, përveç produkteve bonjake¹⁷. Ky lloj autorizimi quhet Autorizim Marketing. Përmes Udhëzimit Administrativ 02/2014¹⁸, është lejuar të bëhet importi i barnave bonjake që nuk kanë AM në Kosovë, por që janë të regjistruar në një vend të Bashkimit Europian. Mirëpo ky UA është interpretuar nga vetë Ministria e Shëndetësisë si jo në përputhje me Ligjin për Produkte dhe Pajisje Medicinale, ndonëse një dispozitë e tillë parashihet në ligj¹⁹. Duke qenë se Kosova është një treg i vogël dhe jo atraktiv për prodhuesit farmaceutik²⁰, deri në muajin mars 2022 në secilin tender të publikuar nga MSH është lënë si mundësi që nëse një produkt nuk ka AM për Kosovë, të lejohet importi nga ndonjë vend i BE.

Ministria e Shëndetësisë në aktivitetin e prokurimit për furnizim me insulina analoge nga Lista Esenciale²¹ ka hequr si kriter të dosjes së tenderit pjesën që flet për përdorimin e Udhëzimit Administrativ 02/2014 Për thjeshtësimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale të cilat nuk kanë paralele të regjistruara në Republikën e Kosovës. Kërkesa në dosje të tenderit tani është formuluar kështu:



“Operatori ekonomik duhet te dëshmoj regjistrimin e produktit nga AKPPM - Autorizimi për Marketing në Kosovë, me dozën e produkteve të kërkuar”.

Pra sipas fjalisë, vërehet që UA 02/2014 nuk aplikohet më, dhe vetëm një produkt që ka Autorizim Marketing në Kosovë mund të fitojë kontratën. Gjatë fazë së tenderit një operator ekonomik ka bërë kërkesë për sqarim të tenderit. Ministria e Shëndetësisë ka kthyer një përgjigje e ku bashkëngjitur me të një opinion ligjor²². Sipas këtij opinion UA 02/2014 është në kundërshtim me Ligjin Nr. 04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale (LPPM). Sipas opinionit ligjor, vetëm produktet me AM mund të shiten në Kosovë, ndërsa vetëm në raste të caktuar e kur të plotësohen kushte specifike ato mund të tregtohen pa AM. Si konkluzion, opinionin ligjor në fund thotë:

¹⁷ Ligji nr. 04/L-190 për produkte dhe pajisje medicinale

¹⁸ Udhëzimi Administrativ 02/2014. Ministria e Shëndetësisë <https://msh.rks-gov.net/ep-content/uploads/2014/05/U-A-Nr-02-2014-P-C3%ABr-thjesht-C3%ABsimin-e-procedurave-p-C3%ABr-regjistrimin-dhe-importin-e-produkteve-medicinale-t-C3%AB-cilat-nuk-kan-C3%AB-paralele-t-C3%AB-regji-2.pdf>

¹⁹ Ligji nr. 04/L-190 për produkte dhe pajisje medicinale, Neni 12 Importi i produkteve medicinale, pika 15: AKPPM mund të lejoj importin pa Autorizim Marketingu të Produkteve Medicinale Bonjake të definuara me Rregulloret e BE apo të Produkteve që përfshihen në Listën Shtetërore të Produkteve Bonjake me kusht që këto produkte të mos jenë të regjistruara në Republikën e Kosovës. Listën Shtetërore të Produkteve Bonjake epërcakton nën-komisioni i emëruar nga AKPPM dhe ajo rishikohet në baza mujore. Kjo listë publikohet nga AKPPM.

²⁰ Kriteret e tenderëve, ndikimi në konkurrencë, KDI 2019

²¹ Prokurimi Nr. 206-22-2211-1-1-1

²² Pjesë nga Opinioni Ligjor është publikuar në faqen e tenderit https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=1802646

Ministria e Shëndetësisë në të gjitha rastet të cilat nuk bien në fushëveprimin e nenit 16. Par. 5, do të kërkojë domoshmërisht Autorizim Marketingun e produkteve medicinale pasi që e njëjta është kërkesë ligjore.

Nga kjo nënkuptohet që në tenderët e ardhshëm MSH do të kërkojë vetëm AM në dosje të tenderit dhe nuk do të aplikohet UA 02/2014, përveç nëse plotësohet një nga kriteret e nenit 16, paragrafi 5 të LPPM.

Por situata në SHSKUK është ndryshe. KDI ka vërejtur që SHSKUK vazhdon të publikojë aktivitete të prokurimit e ku ende vazhdon të përdoret UA 02/2014 si kriter i dosjes së tenderit.

Moskomunikimi ndërmjet dy institucioneve kryesore të fushës së shëndetësisë ka bërë që njëra të blejë produkte edhe kur nuk kanë AM të regjistruar në Kosovë, e tjetra kërkon që vetëm me AM mund të ofertohet. Pavarësisht kësaj, Ministria e Shëndetësisë ka publikuar një tender²³ e ku nuk ka kërkuar fare AM. Kjo bie ndesh me fjalinë e dhënë në Opinion Ligjor e ku thotë që MSH do të kërkojë AM për produkte medicinale. Pasi është bërë njoftimit për dhënie të kontratës, kontrata nuk është nënshkruar, por është njoftuar operatori ekonomik se Sekretari i Përgjithshëm (ZKA) ka refuzuar nënshkrimin e kontratës me arsyen se nuk është kërkuar AM në dosje të tenderit. Tenderi është anuluar, çka e ka shtyrë kompaninë fituese të ankohet në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

d) Efikasiteti i prokurimeve

Institucionet shëndetësore publike kanë për obligim diagnostikimin dhe trajtimin e pacientëve me COVID-19, ndërsa për personat të cilët janë të prekur nga ky virus Qeveria e ka për obligim që të mbulojë shpenzimet e ekzaminimit dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore në mënyrë të menjëhershme dhe falas, pavarësisht nivelit të kujdesit publik shëndetësor.²⁴ Analiza e përmbushjes së detyrimeve ligjore të përcaktuara nga ligji për pandeminë COVID-19²⁵ ka gjetur se pacientëve të cilët janë trajtuar në SHSKUK dhe janë të shtrirë në spital iu është siguruar një pjesë e barërave ndërsa pacientet të cilët janë infektuar, por atyre që nuk ishin hospitalizuar nuk u janë siguruar barërat për trajtim dhe ata janë detyruar që barnat të blejnë me mjete vetanake.

Një nga produktet që është kërkuar më së shumti në treg për luftimin e COVID-19 nga pacientët më rëndë të prekur ishte produkti Remdesivir. Remdesiviri është një medikament antiviral i zbuluar nga kompania farmaceutike Gilead

Sciences, i cili shitet me emrin tregtar, Veklury. Pas shfaqjes së Covid-19 në disa shtete Remdesiviri u aprovua për trajtim të pacientëve të prekur me Covid-19. Në Shtetet e Bashkuara, Administrata e Barërave dhe Ushqimit (FDA) më 1 maj 2020 lëshoi një autorizim emergjent për përdorimin e Remdesivir, ndërsa në Indi u aprovua më 1 qershor 2020²⁶. Deri më tani më shumë se 50 shtete kanë lëshuar autorizime për përdorim emergjent të këtij bari.

Brenda periudhës 13 mujore, 13 gusht 2020, kur edhe Remdesiviri u aprovua për trajtim e deri më 15 shtator 2021 (dita kur është blerë Remdesiviri), rreth 147 mijë qytetarë janë infektuar me Covid-19²⁷. Trajtimi i pacientëve të prekur me Covid-19 është bërë në pesë klinika të SHSKUK dhe nëpër shtatë spitale rajonale. Jo të gjithë personat e infektuar kanë qenë të infektuar rëndë, prandaj numri i personave që kanë qenë të hospitalizuar është më i ulët.

²³ Tenderi “Furnizim me Barna dhe Pajisje të imëta mjekësore për DSHB” me nr të prokurimit 206-22-3716-1-1-1

²⁴ Ligji nr. 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë covid-19, Neni 8, pika 3. Parandalimi, menaxhimi dhe kontrolli i pandemisë COVID-19 ofrohet falas për qytetarët në të gjitha institucionet publike shëndetësore.

²⁵ Ligji nr. 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë covid-19

²⁶ India approves emergency use of remdesivir to treat Covid-19 patients | India Neës - Times of India (indiatimes.com)

²⁷ Coronavirus Dashboard. Organizata Botërore e Shëndetësisë <https://covid19.who.int/EHO-COVID-19-global-data.csv>

Siç e ka gjetur edhe raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit, barnat që përshkruhen nga mjekët e që pacientët i blejnë vetë nuk mblidhen e nuk regjistrohen në ndonjë databazë²⁸.

Sipas të dhënave nga ZKA, për një periudhë gjashtë mujore vetëm në një repart të Klinikës Infektive (nga gjithsejt pesë reparte),



135 pacientëve

u është përshkruar Remdesivir.



Secili ka blerë nga **10 deri 14²⁹** doza (injeksione).

Nëse secili nga këta **135 pacientë**



ka blerë mesatarisht 11 injeksione me një çmim mesatar prej

180 euro/dozë,

atëherë ata kanë shpenzuar

267,300 euro.

Mirëpo kjo shumë supozohet të jetë dukshëm më e lartë pasi nuk merr për bazë edhe pacientët që trajtohen në repartet, klinikat dhe spitalet rajonale tjera.

Duke u nisur nga gjetjet e ZKA, KDI ka nxjerrë një përllogaritje të shpenzimeve që pacientët mund t'i kenë bërë për blerje të remdesivir, si në vijim:

- Në SHSKUK, për rreth një vit ka pasur mungesë të Remdesivir
- Nëse në 5 klinika të SHSKUK-së dhe në 7 spitale rajonale, çdo muaj kanë qenë të hospitalizuar mesatarisht 10 pacientë, të cilëve u është përshkruar Remdesivir, numri i pacientëve llogaritet të jetë 1440. (12 klinika/spitale*10 pacientë*12 muaj).
- Çmimi mesatar i një ampulë Remdesivir për periudhën shtator 2020 - shtator 2021 llogaritet të jetë 50 euro, bazuar në çmimet referente të periudhës nëntor-dhjetor 2020, ku çmimi i një

ampule ka qenë rreth 200 euro, dhe çmimeve të muajit shtator 2021, që kanë qenë nga 30 deri 50 euro. Secili pacient mesatarisht ka blerë 11 ampula për trajtim, që i bie që kosto për trajtim për secilin pacient sillet rreth 550 Euro (1*11 ampula*50 euro).

- Shpenzimet e përafërta për trajtim për të cilat 1440 qytetarë kanë paguar nga xhepi i tyre llogariten të jenë **792,000 euro** (1440 pacientë * 550 Euro kosto e trajtimit me Remdesivir)

²⁸ Zyra Kombëtare e Auditimit. Furnizimi me barëra dhe materiale shëndetësore për t'iu përgjigjur nevojave të pacientëve me COVID-19, faqe 11. 2021. <https://www.zka-rks.org/ep-content/uploads/2021/12/Raporti-auditimit-Covid19-pjesa1-Shqip.pdf>

²⁹ Ibid



Kjo kosto mund të jetë edhe më e lartë, për shkak që numri i pacientëve mund të ketë qenë shumë më i lartë dhe përbën shkelje të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19, i cili paradoksalisht u përdor për të gjobitur qytetarët për mosrespektim të masave kundër Covid-19.

Në vazhdim, raporti i Zyrës Kombëtare e Auditimit për menaxhimin e COVID-19 shpërfaq mungesa të shumta të barnave nëpër spitale rajonale³⁰. Produkti Imipenem + Cilastatine plv per sol per inj 500mg ka munguar për 20 ditë në Spitalin e Pejës në periudhën nëntor 2020, në kohën kur numri i rasteve me infektim në ditë ishte mbi 800. Një mungesë tjetër më e madhe, kishte zgjatur për dy muaj e gjysëm, dhjetor 2021 – shkurt 2022. Mirëpo për këtë produkt ka pasur kontratë të nënshkruar më 24 nëntor 2021 dhe janë blerë 329,000 copë. Qytetarët janë detyruar që të blejnë vetë këtë produkt, i cili ka rënduar buxhetin e tyre.

E njëjta gjë ka ndodhur edhe në Spitalin e Prizrenit³¹. Edhe këtu produkti i njëjtë, Imipenem + Cilastatine plv per sol per inj 500mg ka munguar në periudhën 1 deri 18 prill 2021, edhe pse pra kishte kontratë aktive që nga nëntori 2021 me kohëzgjatje prej 24 muajve.

Ky është vetëm një ilustrim se si mungesa e produkteve në spitale nuk ka ardhur si pasojë e mungesës së kontratës, por si pasojë e mos komunikimit të duhur në mes të institucioneve, gjë që ka shtyrë që pacientët të blejnë vetë me dikamentin.

Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 thotë se çdo personi që është i prekur me Covid-19 i ofrohen falas të gjitha shërbimet shëndetësore, përfshirë edhe barnat për trajtimin e virusit³². Megjithatë shumë produkte për luftimin e COVID-19 janë blerë nga vetë qytetarët. Ligji më shumë është përdorur për të rritur të hyrat, përmes dënimeve të shumta ndaj qytetarëve që nuk kanë respektuar masat anti Covid-19. Këto dënime nuk kanë ndikuar që të ulet numri i të infektuarve me Covid-19. Në anën tjetër

³⁰ Raporti-auditimit-Covid19-pjesa1-Shqip.pdf (zka-rks.org)

³¹ Ibid

³² Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. LIGJI NR. 07/L-006 PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E PANDEMISË COVID-19 NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, Neni 5.8. 2020.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=30819>

³³ Asnjë gjobë, partitë shkelin masat kundër COVID-19 (evropaelire.org)

³⁴ <https://kosovapress.com/ska-rimbursim-per-barnat-e-blera-gjate-pandemise-msh-thote-se-nuk-ka-skeme-te-rimbursimit-te-terapive/>

³⁵ <https://shendetesia.gov.al/manastirliu-nga-sot-rimbursim-100-te-trajtimit-ambulator-per-pacientet-me-covid-19-do-trajtohen-te-siguruarit-dhe-te-pasiguruarit/>



Shpenzimet e përafërta për trajtim për të cilat 1440 qytetarë kanë paguar nga xhepi i tyre llogariten të jenë 792,000 euro (1440 pacientë * 550 Euro kosto e trajtimit me Remdesivir)

partitë politike që kanë shkelur të njëjtat masa janë gjobitur fare pak³³. Rimbursimi i qytetarëve nuk është ngritur asnjëherë si temë në Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Ministria e Shëndetësisë në një prononcim për media ka thënë se nuk ka skema të rimbursimit për shkak që Kosova nuk ka sigurime shëndetësore³⁴. Megjithatë kjo arsye nuk qëndron pasi rimbursimi ka mundur të bëhet direkt, për pacientët që ofrojnë dëshmi që kanë blerë vetë produktet për trajtimin e Covid-19. Është e çuditshme se si një nga nenet më së shumti që është zbatuar nga Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19, qëllon të jetë neni që krijon të hyra për shtetin, e ai më së paku i zbatuar është neni që thotë që trajtimi për luftimin e Covid-19 duhet të jetë falas.

Ndërkohë, Shqipëria në fund të vitit 2020 ka njoftuar se rimbursimi do të bëhet si për qytetarët e siguruar, e po ashtu edhe për ata të pasiguruar³⁵.



e) Analiza e procedurave të prokurimit / Ekonomiciteti i shpenzimeve

Furnizimi me Remdesivir

Në Kosovë, përdorimi i Remdesivir për trajtimin e pacientëve me Covid-19 u rekomandua përmes Udhërrëfyesit Klinik për Menaxhimin dhe Trajtimin e Covid-19³⁶, të publikuar më 11 gusht 2020. Kërkesa e SHSKUK për ta blerë këtë produkt u inicua pas një muaji e gjysëm, respektivisht me 24 shtator 2020³⁷, ku ishte planifikuar të blihen 1,320 njësi (për 120 pacientë nga 11 ampula). Në bazë të hulumtimit të tregut që e kishte bërë Komisioni i themeluar nga MSH për përcaktimin e çmimit, çmimi mesatar në treg për një njësi Remdesivir ishte 252.65 euro. Ky komision gjatë përcaktimit të çmimit të tregut mori si referencë çmimet në dy depo farmaceutike dhe në një barnatore. Mirëpo, në bazë të një tabele të SHSKUK të muajit gusht 2020, kërkesa për Remdesivir ka qenë 7,780 njësi.

Procedura e prokurimit për blerjen e Remdesivir filloi më 16 tetor 2020, ku Ministria e Shëndetësisë përmes procedurës emergjente, u dërgoi ftesë për të ofertuar disa kompanive. MSH zgjodhi procedurën emergjente, pasi kërkesa për furnizim me Remdesivir ishte e lartë. Shtatë kompani ofertuan, ndërsa ofertën më të lirë të përgjegjshme e kishte kompania LEGO, me çmim prej 81 euro për një njësi, apo 213,840 euro për sasinë e kërkuar që ishte 2,640 njësi³⁸. Kompania Santefarm që kishte çmimin më të lirë u tërhoq nga oferta pasi nuk do të mund të siguronte liferimin e produktit në afatin e kërkuar prej 10 ditësh.

Operatori Ekonomik	Vlera totale e ofertës në Euro	Çmimi për njësi në Euro
NPT Medica	382,008	144.70
Interlab Sh.P.K. & SIGMA PHARM Sh.P.K.	435,600	165
Agani L.t.d	486,314.40	184.21
Santefarm Sh.P.K	208,560	79
Liri – Med Sh.P.K	652,924.80	247.32
LEGO Sh.P.K.	213,840	81
Medical Group Sh.P.K	396,000	150

Tabela 1: Ofertat e operatorëve ekonomik për Remdesivir

36 Udhërrëfyesi-Klinik-Menaxhimi-dhe-trajtimi-i-COVID-19.pdf (omk-rks.org)

37 Kërkesa e bërë më 24 shtator 2020 nga Gëzime Pllana, Drejtoreshë e Shërbimit Farmaceutik, QKUK

38 Sipas Dosjes së Tenderit me nr. 206-20-6496-1-1-5



Megjithatë dy kompani tjera u ankuan në MSH, pasi sipas tyre LEGO nuk plotësonte kriterin për autorizim nga prodhuesi. Ankesat u aprovuan pjesërisht nga MSH dhe tenderi u kthye në rivlerësim. Në anën tjetër, qytetarët gjatë kësaj kohe vazhdonin të blinin vet Remdesivirin, përkundër që Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 thotë se çdo personi që është i prekur me Covid-19 i ofrohen falas të gjitha shërbimet shëndetësore, përfshirë edhe barnat për trajtimin e virusit³⁹.

Pas rivlerësimit, MSH më 22 dhjetor 2020 anuloi tenderin me arsyen se Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) në ndërkohë kishte rekomanduar se Remdesiviri nuk ka efekt në trajtimin e pacientëve të infektuar me Covid-19. Po ashtu, MSH kishte sqaruar se çmimet e tregut për Remdesivir që nga data e këtij njoftimi kishin rënë dukshëm, ndërkohë që ofertat e pranuar nga operatorët ishin me çmime më të larta se çmimet të tregut gjatë muajit dhjetor 2020.

Mirëpo, sipas ligjit, MSH është e obliguar që të sigurojë barnat falas për personat e prekur me Covid-19 dhe nuk ka rëndësi sa është kosto, përderisa është brenda buxhetit të zotuar. Duke monitoruar në vazhdimësi blerjet gjatë periudhës së ballafaqimit me situata emergjente të shkaktuara nga COVID-19, KDI ka gjetur se në çdo produkt ka pasur lëvizje të çmimeve dhe duke u bazuar në trendet e furnizimeve paraprake vlerëson se është e kuptueshme që një produkt, oferta për të cilin është dorëzuar në tetor 2020, të ketë çmim tjetër në treg në dhjetor 2020. Ka shumë kontrata që janë nënshkruar në vitin 2019 e që kanë pasur çmime tjera në vitin 2020.

Kompania LEGO u ankua në Organin Shqyrtues të Prokurimit, i cili vërtetoi anulimin e tenderit nga MSH⁴⁰. Në arsyetim të vendimit OSHP përmend arsyetimin që ka dhënë MSH, që Remdesivir nuk rekomandohet për përdorim nga OBSH dhe se çmimi i këtij produkti ka rënë dukshëm.

Mirëpo, në anën tjetër pikërisht në kohën kur është anuluar tenderi, klinikat dhe spitalet në Kosovë kanë vazhduar t'ua përshkruajnë Remdesivirin për trajtim të disa pacientëve të prekur me Covid-19. Në bazë të dokumenteve të pranuar nga MSH dhe SHSKUK, KDI nuk ka gjetur se ka pasur një dakordim paraprak ndërmjet niveleve të institucioneve shëndetësore që mos të mos të përshkruhet një medikament i cili nuk ishte më i rekomanduar nga OBSH, dhe i cili nuk do të sigurohej nga institucionet publike shëndetësore. Ky mos koordinim ka shtyrë institucionet të shkelin Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19, me ç' rast nga mungesa e barit në stokun publik, pacientët janë detyruar ta blejnë privatisht. Respektivisht, para anulimit të tenderit nga MSH mbi bazën e rekomandimeve të OBSH-së, është dashur të komunikohet dhe dakordohet me SHSKUK-në, në mënyrë që profesionistët shëndetësor të mos vazhdojnë t'u përshkruajnë këtë medikament për trajtim, apo në të kundërtën të vazhdohet me blerjen.

Megjithatë, në shtator 2021, respektivisht nëntë muaj pas anulimit të tenderit të lartë cekur, Remdesivir u ble nga MSH edhe pse OBSH asnjëherë nuk doli më një rekomandim tjetër, i cili anulon rekomandimin paraprak për mos t'a përshkruar atë si terapi integrale në trajtimin e pacientëve të prekur nga COVID-19.

Marrëveshja me Bashkimin Europian dhe kredia nga Banka Botërore

Mirëpo Kosova ka mundur të blej Remdesivirin shumë më herët. Disa muaj para se të bëhet kërkesa për inicim të procedurave të prokurimit për blerjen emergjente të Remdesivir, Kosova kishte nënshkruar një marrëveshje me Bashkimin Europian (BE) që të bëhet pjesë e Marrëveshjes për Prokurim të Përbashkët. Marrëveshja ishte nënshkruar më 28 prill 2020⁴¹, ndërsa më 8 tetor 2020, Komisioni Europian nënshkroi një kontratë të përbashkët të prokurimit me prodhuesin e Remdesivir, Gilead⁴². Kjo marrëveshje, nuk përjashtonte mundësinë që shtetet të mund të blejnë edhe direkt nga Gilead ilaçin Remdesivir⁴³. Mirëpo Kosova asn-

39 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë covid-19 në territorin e republikës së Kosovës, neni 5.8. 2020. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=30819>

40 Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimi 87/21. 2021.

41 Signing ceremonies for Joint Procurement Agreement | Public Health (europa.eu)

42 Coronavirus: Remdesivir (europa.eu)

43 Gilead Sciences Signs Joint Procurement Agreement With the European Commission for Veklury® (remdesivir)



Marrëveshja financiare u nënshkrua fillimisht për një vlerë prej

46 milion euro, e pastaj edhe për **15 milion euro.**

Këto mjete do të shërbenin për blerje të medikamenteve, pagesat shtesë për mjekët dhe infermierët dhe për pagesa të tjera.

Sipas marrëveshjes, mjetet e kredisë që shpenzohen përmes prokurimit, i nënshtrohen rregullave të prokurimit të BB. Ministria e Shëndetësisë si zbatuese e projektit, e kaloi përgjegjësinë për prokurim të barërave tek Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS).

UNOPS për të menaxhuar projektin, do të marrë nga buxheti një tarifë të shërbimit prej rreth **1 milion euro.**

jëherë nuk e ka shfrytëzuar këtë marrëveshje për të blerë Remdesivir. Sipas deklaratës së dhënë nga ish-ministri Arment Zemaj, marrëveshja nuk është shfrytëzuar për arsye të çmimit të lartë⁴⁴

Si pasojë e shkurtimeve buxhetore dhe nevojës për mjete financiare, Kosova më 29 qershor 2020⁴⁵ nënshkroi një kredi me Asociacionin Ndërkombëtar për Zhvillim (IDA) i cili është pjesë e Bankës Botërore (BB) për financim të projektit "Projekti Emergjent Covid-19 për Kosovën". Marrëveshja financiare u nënshkrua fillimisht për një vlerë prej 46 milion euro, e pastaj edhe për 15 milion euro shtesë. Këto mjete do të shërbenin për blerje të medikamenteve, pagesat shtesë për mjekët dhe infermierët dhe për pagesa të tjera. Sipas marrëveshjes, mjetet e kredisë që shpenzohen përmes prokurimit, i nënshtrohen rregullave të prokurimit të BB. Ministria e Shëndetësisë si zbatuese e projektit, e kaloi përgjegjësinë për prokurim të barërave tek Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS). UNOPS për të menaxhuar projektin, do të marrë nga buxheti një tarifë të shërbimit prej rreth 1 milion euro.

Blerja e Remdesivir përmes UNOPS

MSH ia barti UNOPS-it përgjegjësinë për blerje të disa barëve në dhjetor të vitit 2020. Përderisa nuk ka informacione nëse MSH i ka kërkuar zyrtarisht UNOPS-it të blejë Remdesivir, gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2021 qytetarët kanë vazhduar të blejnë Remdesivir me paratë e tyre. Megjithatë një procedurë e mbyllur prokurimit është zhvilluar vetëm në fillim të shtatorit të vitit 2021⁴⁶. UNOPS, me 1 shtator 2021, u ka dërguar ftesë për të ofertuar disa kompanive. Tenderi përbëhet nga disa lote, ku në njërin prej tyre ishin kërkuar 7,920 njësi Remdesivir. Edhe pse nuk ishte e klasifikuar si procedurë emergjente e prokurimit, afatet ishin shumë të shkurtëra. Afati për pyetje rreth tenderit ishte vetëm një ditë, pra deri më 2 shtator 2021, ndërsa ofertat kërkohej të dorëzoheshin më 6 shtator 2021, apo vetëm pesë ditë pas shpalljes. Ndërsa dorëzimi i produkteve u kërkuar të bëhej vetëm tre ditë pas nënshkrimit të kontratës. Fitues i kontratës është kompania Scheham Sh.P.K, ndërsa vlera e kontratës ishte 102,880.80 euro apo 12.99 euro për një njësi Remdesiviri. Ky çmim ishte gati 6-fish më i ulët se çmimi të cilin MSH kishte tentuar t'a blejë një vit më parë. KDI argumenton se janë disa arsye se pse çmimi është më i ulët:



Scheham ka ofertuar produktin pa emër tregtar të kompanisë Health Biotech nga India⁴⁷. Zbuluesi i Remdesivir, Gilead në vitin 2020 në mënyrë vullnetare u kishte dhënë licencë jo-ekskluzive shtatë kompanive në Egjipt, Indi dhe Pakistan për të prodhuar Remdesivir në formë gjenerike. Këto kompani kanë të drejtë që të prodhojnë dhe të vendosin vetë çmimin e shitjes. Marrëveshja lejon që produkti gjenerik të mund të eksportohet në 127 vende të botës⁴⁸. Sidoqoftë, janë dy probleme me produktin e Health Biotech;

- kjo kompani nuk është e autorizuar nga Gilead
- Kosova nuk është në listën prej 127 vendeve (nuk është asnjë vend nga Ballkani)

Sipas raportimeve në mediat në Indi⁴⁹, drejtori i kompanisë Health Biotech është arrestuar për shitje ilegale të Remdesivir. Raportimet gjithashtu theksojnë që gjatë arrestimit janë konfiskuar 3,000 doza Remdesivir, për të cilat drejtori i kësaj kompanie nuk ka pasur dokumentacion që tregojnë se kompania është e autorizuar që të prodhojë dhe eksportojë Remdesivirin. Blerja e një produkti të patentuar nga një kompani e cila nuk është e licencuar, është shkelje e rëndë e ligjeve në fushën e patentave dhe konventave ndërkombëtare.

Furnizim me oksigjen

Gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, një nga produktet që është përdorur më së shumti, është oksigjeni (në formë të gazët dhe atë të lëngshme), i cili është përdorur për trajtimin e pacientëve të shtrirë në spitale. Përderisa para pandemisë, kërkesa për oksigjen ka qenë më e vogël, gjatë pandemisë kërkesa është rritur për disa herë.

Në vazhdim janë analizuar dy procedura të prokurimit ku Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK) përmes disa vendimeve ka bërë që të paguajë më shtrenjtë oksigjenin. SHSKUK në fillim të pandemisë, në vitin 2020 lidhi kontratë (numri i prokurimit 00220-20-312-1-1-1) me kompaninë me kompaninë Medical Group

për Furnizim me oksigjen për inhalim për përdorim në menaxhimin e hipoksisë. Çmimi i kontratës për një kilogram oksigjen ishte 1.68 euro dhe në total kontrata parashihte që të porositeshin 485,736 kg. Pasi kontrata ishte e tipit të kontratës kornizë lejohej që të porositeshin deri në 30% më shumë sasi. Kontrata u nënshkrua më 6 maj 2020. Mirëpo vetëm dy muaj më vonë, më 23 korrik 2020, SHSKUK nënshkruan një kontratë tjetër përmes procedurës së negociuar (nr. i prokurimit 00220-20-3783-1-1-5) me kompaninë Medica, për furnizim të njëjtë, mirëpo këtë herë me çmim 2.01 euro për kg oksigjen. Sasia që është porositur përmes kësaj kontratë është 44,250 kg. SHSKUK për këtë sasi ka paguar 88,942.50 euro. Mirëpo ka mundur që të njëjtën sasi ta porosisë përmes kontratës që kishte me kompaninë Medical Group. Diferenca prej 0.33 euro në çmim (2.01 – 1.68) bën që për sasinë e porositur të ketë një dallim në çmim prej 14,602.50 euro. Pra, sikur SHSKUK të porosishte oksigjenin përmes kontratës me çmim më të lirë do të kursente 14,602.50 euro.

Arsyet pse ka ndodhur që të ketë dy kontrata të njëjta mund të jenë të ndryshme, mirëpo një nga arsyet ka mundur të jetë që kompania nuk ka qenë në gjendje të përballojë kërkesën dhe është dashur edhe një kompani tjetër që të mbulojë këtë kërkesë. KDI ka parë disa komunikime përmes email të spitaleve rajonale me SHSKUK e ku shprehet brenga e madhe që nuk kanë furnizime të mjaftueshme me oksigjen, në kohën kur numri i rasteve me COVID-19 ishte shumë i lartë. Në dosje të tenderit të tenderit me procedurë të hapur, SHSKUK ka vendosur afatin e liferimit 3-5 ditë, mirëpo nuk ka vendosur se sa do të jetë sasia minimale që duhet të liferohet brenda 24 orëve ose brenda javës (këtë gabim e ka përmirësuar në tenderin me procedurë të negociuar, e ku ka specifikuar se sa duhet të jetë sasia minimale që duhet të liferohet brenda javës). Një gabim në dosje të tenderit, pra mos specifikimi i sasisë minimale që duhet të liferohet brenda një periudhe të caktuar, ka bërë që të lidhet edhe një kontratë tjetër për të njëjtin furnizim, por me çmim më të lartë. Për të marrë shembull se sa është i rëndësishëm specifikimi i sasisë minimale, mund të merret kontratë për prodhim të dokumenteve të gjendjes civile. Kompania e kontraktuar e ka ditur paraprakisht në dosje

⁴⁴ Deklarata e dhënë gjatë tryzës së organizuar nga KDI me titull "Pse qytetarët u detyruan ta blejnë vetë Remdesivirin" mbajtur më 21 mars 2022
⁴⁵ LIGJI NR. 07/L-030 PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES KORNIZË PËR KREDI NDËRMJET BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EVROPËS DHE KOSOVËS - INSTRUMENTI PËR FINANCIM TË SEKTORIT PUBLIK PËR REAGIM EMERGJENT NDAJ COVID-19
⁴⁶ RFQ Ref No: 22998-RFQ-006

⁴⁷ Postimi në Facebook nga SHSKUK më 15 shtator 2021.
 (1) Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës | Facebook
⁴⁸ Voluntary Licensing Agreements for Remdesivir (gilead.com)
⁴⁹ Remdesivir illegal sale racket busted | Chandigarh Neës - Times of India (indiatimes.com)





të tenderit sasinë e kërkuar, dhe sasinë që duhet të liferohet çdo muaj. Nëse kompania nuk do të kishte kapacitet të prodhimit për sasinë e kërkuar mujore, atëherë me siguri nuk do të ofertonte.

Ndërsa aktiviteti tjetër i prokurimit i analizuar ka të bëjë me oksigjenin e lëngshëm. SHSKUK më 1 prill 2021 publikoi aktivitetin e prokurimit "Furnizim me oksigjen medicinal për nevojat e SHSKUK" me numër të prokurimit 00220-

21-1709-1-1-1. SHSKUK planifikoi të blinte 5.2 milion litra oksigjen, ndërsa vlera e parashikuar e tenderit ishte 2.44 milion euro, ndërsa vlera e parashikuar për një litër oksigjen ishte 0.47 euro. Kontrata paraprake, ishte lidhur me çmim të njëjtë 0.47 euro, me kompaninë Medical Group. Në aktivitetin e prokurimit morë pjesë tre operatorë ekonomik:

Operatori ekonomik	Çmimi i përgjithshëm (në euro)	Çmimi për litër (në euro)
Medical Group SH.PK	1,976,000	0.38
Liri – Med SH.PK	2,392,000	0.46
NPT Medica	1,924,000	0.37

Tabela 2. Ofertat e dhënë në tenderin 00220-21-1709-1-1-1

Sipas raportit të vlerësimit të tre operatorët ekonomik u cilësuan të përgjegjshëm dhe për kontratë u rekomandua, OE më i lirë, NPT Medica që ka ofertuar me 0.37 euro për litër. Raporti i vlerësimit është nënshkruar nga tre anëtarët e komisionit, por jo edhe nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit (Drejtori i Zyrës së Prokurimit). Sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP)⁵⁰, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit (ZPP) merr vendim përfundimtar sa i përket dhënies së kontratës. ZPP mund të pranojë rekomandimin e komisionit të vlerësimit apo ta refuzojë atë. Nëse rekomandimi refuzohet, atëherë ZPP duhet të tregojë me shkrim arsyet e refuzimit. Pasi ZPP nuk ka nënshkruar raportin e vlerësimit, kuptohet që ai ka refuzuar rekomandimin e Komisionit të Vlerësimit. Por nuk ka ndonjë dokument, ku ZPP ka dhënë arsyetimet e tij për refuzim.

Megjithatë, tenderi u anulua pas kërkesës së datës 4 qershor 2021 të bërë nga Barnatorja Qendrore. Sipas BQ, pas

zvogëlimit të rasteve me COVID-19 është zvogëluar edhe kërkesa për oksigjen medicinal. Përmes kërkesës me numër protokollit 4195, BQ kërkoi nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA), që në këtë rast është Drejtori i SHSKUK që të anulohet procedura e prokurimit. Anulimi i kësaj procedure do të nënkuptonte që do të vazhdohej të bëheshin porosi me oksigjen me kontratën aktive në atë kohë (kontrata me OE Medical Group, me çmim 0.47 euro për litër), por që në muajin qershor 2021 kishte arritur në rreth 84% të sasisë së shpenzuar. Përfundimisht më 16 qershor 2021, publikohet Njoftimi për Anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Mirëpo i gjithë procesi që nga publikimi i tenderit e deri te anulimi ka kaluar me vonesa të panevojshme, në kohën kur çmimi i ofertës më të lirë ishte për 0.10 euro më i ulët se çmimi i kontratës aktive. Më poshtë është dhënë kronologjia prej publikimit të njoftimit për kontratë e deri te anulimi i tenderit:

⁵⁰ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, Neni 40.13 <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret//shq/A01%20Rregullat%20dhe%20Udh%C3%ABzuesi%20operativ%20p%C3%ABr%20Prokurimin%20Publik.pdf>




Anulimi i kësaj procedure do të nënkuptonte që do të vazhdohej të bëheshin porosi me oksigjen me kontratën aktive në atë kohë



(kontrata me OE Medical Group, me çmim **0.47 euro për litër**),

por që në muajin qershor 2021 kishte arritur në rreth



- Njoftimi për kontratë është publikuar më 1 prill 2021
- Afati për dorëzimin e ofertave ka qenë 26 prill 2021
- Komisioni i vlerësimit është formuar më 17 maj 2021
- Raporti i Komisionit të Vlerësimit ka përfunduar më 19 maj 2021
- Kërkesa për anulim të tenderit është bërë më 4 qershor 2021
- Kërkesa ka arritur në Zyrën e Prokurimit më 14 qershor 2021
- Tenderi është anuluar më 16 qershor 2021

Siç mund të vërehet që nga momenti kur janë dorëzuar ofertat (26 prill) e deri te anulimi i tenderit ka kaluar rreth 50 ditë. Sipas nenit 41.2 të RRUOPP, Komisioni i Vlerësimit të ofertave është dashur të formohet jo më vonë se pesë ditë pas hapjes së tenderëve, e ai është formuar 23 ditë pas hapjes së ofertave.

Zyra e Prokurimit nuk ka publikuar fare dokumentin B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues, e ku në të do

të duhet të ishin arsyet për anulimin e tenderit si dhe Letrat standarde për tenderuesit e eliminuar. Pa letrat standarde dhe pa publikim të dokumentit B58, SHSKUK ua ka mohuar të drejtën e ankesës operatorëve ekonomik.

Aktiviteti i prokurimit është anuluar duke u bazuar në nenin 62.1.1 të Ligjit për Prokurim Publik, me arsyen se një shkelje e Ligjit aktual ka ndodhur ose do të ndodhë nëse vazhdohet me procedurën e prokurimit⁵¹.

Sipas kërkesës së bërë nga Barnatorja Qendrore, shihet që nuk ka ndodhur asnjë shkelje e Ligjit aktual. Prandaj as SHSKUK nuk ka qenë në gjendje të tregojë se cili ligj është shkelur ose do të shkelje nëse do të vazhdohej me dhënien e kontratës për OE të rekomanduar. Në fakt mos vazhdimi me dhënien të kontratës ka ndikuar që SHSKUK të humb një shumë të konsiderueshme të mjeteve financiare për shkak që çmimi për litër oksigjen i kontratës ekzistuese ishte për 10 cent më i lartë se i ofertës së OE Medica, në tenderin e anuluar.

Arsyeja për anulim, se kërkesa për oksigjen ka rënë mund të jetë e saktë, mirëpo gjatë muajit qershor 2021 vazhdimisht ka pasur raportime në media se varianti Delta është duke u përhapur me shpejtësi. Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve në SHBA (CDC)⁵² në muajin qershor 2021 e ka klasifikuar variantin delta si VOC (variant

⁵¹ Neni 62.1 i LPP thotë: 1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet: 1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

⁵² SARS-CoV-2 Variant Classifications and Definitions (cdc.gov)





of concern apo variant për shqetësim) dhe i cili po përhapej me shpejtësi më të madhe se variantet e mëhershme.

Mirëpo edhe pse është anuluar tenderi, gjatë kësaj kohe SHSKUK ka vazhduar të porosisë oksigjen me kontratën që ishte aktive. Vetëm gjatë muajit maj dhe qershor 2021 janë porositur 190,000 litra oksigjen. Ndërsa nga muaji maj e deri në muajin gusht 2021, kur është nënshkruar një kontratë e re duke përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë janë porositur 428,000 litra oksigjen. Pra përderisa tenderi është anuluar në qershor 2021, më 23 gusht 2021, SHSKUK ju ka dërguar ftesë tre OE për të ofertuar përmes procedurës së negociuar. Po të llogariten me çmimin e kontratës ekzistuese 428,000 litra oksigjen kanë kushtuar 201,160 euro, ndërsa nëse do të nënshkruhej kontrata me kompaninë Medica, kjo sasi do të kushtonte 158,360 euro (428,000 * 0.37). Diferenca në mes të dy çmimeve është 42,800 euro. SHSKUK e ka dëmtuar buxhetin e saj për 42,800 euro pasi nuk ka nënshkruar kontratën që kishte çmim më të lirë, mirëpo ka anuluar procedurën e prokurimit dhe ka vazhduar të bëjë porosi me kontratën ekzistuese që kishte çmim më të lartë për 0.10 euro për litër.

Më 27 gusht 2021, SHSKUK nënshkroi kontratë të negociuar me kompaninë Medical Group me çmim 0.36 euro për një litër oksigjen. Pra kjo kontratë, ka mundur të mos ekzistonte fare, sikur të lidhej kontrata në muajin qershor me kompaninë Medica, me çmim prej 0.37 euro.

Të dy rastet e analizuar më lart shpërfaqin një mos përgatitje dhe mungesë të analizës në SHSKUK. Në të dy rastet për shkak të veprimeve të gabuara oksigjeni është blerë më shtrenjtë, duke shkaktuar humbje në buxhet prej rreth 57,000 euro.

Furnizim me ceftriaxone

Produkti ceftriaxone është një nga produktet që është përshtetur për pacientët e prekur me Covid-19. SHSKUK ka lidhur një kontratë me kompaninë Liri Med në fund të vitit 2021 me çmim për 0.24 euro. Gjatë zbatimit të kontratës është raportuar në media se është gjetur një copë metali

në paketimin e produktit. Për këtë Inspektorati Farmaceutik ka bllokuar të gjithë stokun e mbetur⁵³. Produkti ka qenë prodhim i një kompanie nga India të quajtur Syner Medico. Pasi është pezulluar produkti, rrjedhimisht as kontrata nuk ka mundur të vazhdojë të zbatohet. SHSKUK në nevojë të këtij produkti, në fillim të muajit shkurt 2022 publikoi tenderin për furnizim me ceftriaxone, me vlerë të parashikuar prej 0.24 euro⁵⁴. Menjëherë ky lot anulohet me arsyen se SHSKUK ka kontratë valide (kontrata me Liri Med). Përderisa njoftimi mban datën 10 shkurt 2022, raportimet në media kishin filluar një muaj më herët. Vlera e parashikuar prej 0.24 euro do t'i jepte mundësi Liri Med që përsëri të oferton-te. Sidoqoftë, më 25 shkurt 2022, SHSKUK prapë publikon tender të ri, por kësaj radhe me vlerë të parashikuar prej 0.45 euro, e cila është gati dyfish më e lartë se e kontratës së fundit⁵⁵. Kësaj radhe në tender, Liri Med nuk merr pjesë fare në tender, ndërsa kontratën e fitoi Provit Pharmaceutical, me çmim prej 0.32 euro. Përderisa në tenderin e vitit 2021 për këtë produkt ka pasur vetëm tre ofertues, në këtë të vitit 2022 janë gjashtë ofertues. Rritja e vlerës së parashikuar ju ka dhënë mundësi më shumë ofertuesve që të ofertojnë. Megjithatë nga pikëpamja e ruajtjes së buxhetit, është lidhur një kontratë për ceftriaxone, vetëm me 4 muaj dallim nga kontrata e vitit 2021, për 33% më e lartë.

Prokurimet përmes UNOPS

Në Kosovë, që nga viti 2017, prej se është funksionalizuar platforma e-Prokurimi, niveli i transparencës në prokurim publik është ngritur dukshëm. Ndërsa që nga viti 2018 në këtë platformë digjitale mund të shkarkohen të gjitha kontratat, përfshirë çmimet për çdo produkt apo shërbim që është blerë. Megjithatë, kalimi i shërbimeve të prokurimit për COVID 19 tek UNOPS, e ka ulur ndjeshëm nivelin e transparencës në prokurimin publik. Kështu, të dhëna të mangëta mbi njoftimet për kontratë apo kontratave publikohen në tri uebfaqe të ndryshme, por jo edhe në platformën shtetërore e-Prokurimi:

- data.unops.org (është faqja ku sipas Rregullave të Prokurimit të UNOPS supozohet se publikohen të dhënat rreth kontratave të nënshkrua nga UNOPS. Megjithatë

53 <https://reporteri.net/lajme/skandali-i-ilacit-me-metal-kompania-liri-med-heshte-inspektorati-e-blokon-stokun-me-me-kete-antibiotik/>

54 Nr. i Prokurimit 00220-22-636-1-1-1

55 Nr. i Prokurimit 00220-22-1077-1-1-1



të dhënat publikohen shumë me vonesë dhe përfshijnë vetëm emrin e kompanisë dhe çmimin total, pa detaje që tregojnë për çmimet e produkteve.

- www.unmg.org, në të cilën duhet të regjistrohen kompanitë, të cilat ofertojnë në tenderë të publikuar nga organizatat e Kombeve të Bashkuara, pjesë e cilës është edhe UNOPS. Në këtë faqe mund të gjenden disa të dhëna rreth kontratave, mirëpo si më lart, publikohet vetëm çmimi i përgjithshëm i kontratës dhe fituesi i saj. Kërkimi në faqe është shumë i vështirë, pasi edhe pse mund të filtrosh të dhënat në bazë të lokacionit, shumë tenderë kanë emërtimin "multiple destinations" apo "në disa vende" si të dhëna. Kjo nënkupton që për të gjetur Kosovën, duhet që disa tituj të kontratave të hapen një e nga një.
- devbusiness.un.org, faqja kryesore ku publikohen tenderët dhe projektet. Kjo faqe mundëson regjistrimin për të marrë informata bazike, mirëpo për të shikuar kontrata dhe tenderët e hapur nevojitet një pagesë vjetore prej 590 dollarë.

Nga këto tri uebfaqe nuk gjenden informata lidhur me me çmimin për njësi, por çmimi është vetëm total. Për më tepër të dhënat e publikuar janë shumë të vjetra, asnjë kontratë e vitit 2022 nuk ka qenë e publikuar deri më 1 qershor 2022. KDI ka tentuar disa herë që të marrë qasje në kontratat e nënshkruara përmes UNOPS, mirëpo përgjigja e tyre ka qenë që kontratat janë të lidhura përmes rregullave të tyre të prokurimit dhe nuk mundësohet publikimi i kontratës.

Mungesa e një faqe ku mund të shkarkohet në tërësi kontrata, e kthen Kosovën disa vite prapa në prokurimin publik.

Kompania Interlab Sh.P.K është futur në Listë të Zezë më 1 shkurt 2021 dhe nuk ka pasur të drejtë të fitojë kontratë deri më 31 janar 2022. Mirëpo kjo kompani në këtë periudhë ka fituar katër kontrata përmes aktiviteteve të prokurimit të udhëhequr nga UNOPS. Ministria e Shëndetësisë si mbikëqyrëse e implementimit të projektit ka dështuar që të kërkojë llogari nga UNOPS se përse një kompani e diskualifikuar është lejuar që të fitojë kontrata të cilat do të paguheshin me para të buxhetit të Kosovës. Një nga kontratat e

fituara është për blerje të veglave të testimit që do të përdoshin për të testuar COVID-19. Si mund t'i besohet një kompanie e cila është diskualifikuar pikërisht për mashtrim dhe deklaratë të rreme. Arsyeja e diskualifikimit nga Organi Shqyrtues i Prokurimit është se Interlab, gjatë implementimit të kontratës ka sjellë një tjetër produkt, krahasuar me atë të dhënë në ofertë⁵⁶.

Sipas Ligjit për Prokurim Publik, nëse një kompani ka bërë falsifikim ose deklaratë të rreme, atëherë mund të futet në Listë të Zezë për një periudhë maksimale prej 12 muajsh. Vendimi merret nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas një kërkesë të bërë nga autoriteti kontraktues. Në këtë rast SHSKUK ka bërë kërkesë e cila është aprovuar nga OSHP. Gjatë periudhës së diskualifikimit, kompania Interlab nuk ka pasur të drejtë që të ofertojë dhe të fitojë kontratë në aktivitete të prokurimit.

Gjatë vitit 2020, Kuvendi i Kosovës i ka miratuar disa kredi ndërkombëtarë, e ku sipas marrëveshjes, prokurimi i disa produkteve mjekësore ka kaluar të Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS). UNOPS i ka rregullat e veta të prokurimit, e ku nuk zbatohet Ligji për Prokurim Publik. Megjithatë, kontrata e dhëna përmes UNOPS janë fonde të Buxhetit të Kosovës. Megjithatë, UNOPS është dashur ta ketë parasysh që kjo kompani ka qenë e diskualifikuar. Vendimi i UNOPS shpërfaq mungesë të respektimit të ligjeve të Kosovës dhe nxit kompanitë që në të ardhmen të tentojnë të fitojnë kontrata përmes aktiviteteve të prokurimit të menaxhuar nga UNOPS.

KDI kërkon nga UNOPS që t'i ketë parasysh të gjitha ligjet e Republikës së Kosovës e sidomos LPP dhe pjesët ku flitet për diskualifikimin dhe përshtatshmërinë e operatorëve ekonomik.

Përmes UNOPS janë blerë disa produkte që kanë pasur çmime shumë të larta, duke marrë parasysh kontratat paraprake të SHSKUK dhe MSH. Në disa raste kontrata është nënshkruar me të njëjtën kompani. Në tabelën më poshtë janë analizuar disa kontrata dhe çmimet e tyre.

56 OSHP. Vendimi 35/21 për Listë të Zezë <https://oshp.rks-gov.net/sq/Documents/Doenload?id=9e0a6cce-5365-eb11-b595-005056ba09d5>





Produkti	Organizata	Çmimi në euro	Periudha ⁵⁷
Piperacilin + Tazobactam	UNOPS	3.27	Janar 2022
	MSH		
	SHSKUK	2.44	Prill 2022
Vancomycin 500mg	UNOPS	2.40	Dhjetor 2021
	MSH		
	SHSKUK	1.08	Prill 2022
Enoxaparin 40mg / 0.4ml	UNOPS	2.80	Dhjetor 2021
	MSH		
	SHSKUK	2.10	Shkurt 2022
Paracetamol 1g, inj.	UNOPS	3.80	Dhjetor 2021
	MSH	0.88	Mars 2022
	SHSKUK	0.84	Tetor 2021

Tabela 1 – Krahasimi i çmimeve për disa produkte në mes UNOPS, MSH dhe SHSKUK

Nga tabela më lart kuptohet se blerjet që bëhen përmes UNOPS më të shtrenjta se ato në MSH dhe SHSKUK. Në disa raste edhe kompania është e njëjtë, dhe periudha pothuajse e njëjtë. Ministria e Shëndetësisë si mbikëqyrëse e zbatimit

të projektit të financuar nga Banka Botërore ka dështuar që të kërkojë llogari nga UNOPS në lidhje me çmimet e larta për disa produkte.

f) Mbikëqyrja e shpenzimeve publike dhe llogaridhënia

Një nga obligimet e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është që të monitorojë zbatimin e ligjeve që bien në fushë veprimtarinë e tyre. Komisioni, në mbledhjen e datës 24 maj 2021⁵⁸ kishte votuar pro monitorimit të zbatimit të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19, ndërsa në takimin e radhës, më 31 maj 2021⁵⁹ kishte formuar grupin punues për të mbikëqyruar zbatimin e këtij ligji.

Grupi punues ka mbajtur disa takime gjatë muajve vijues dhe ka zhvilluar disa takime nëpër institucione shëndetësore. Nga procesverbalet e takimeve të Komisionit nuk përmendet askund fenomeni i blerjes së barnave nga vetë qytetarët, ndonëse, ka pasur dhjetëra raportime në me-

dia që qytetarët janë duke blerë vetë barna për trajtimin e Covid-19, e ndër to edhe Remdesivirin. Deri më tani ka kaluar gati një vit e gjysmë që nga themelimi i komisioneve për monitorimin e zbatimit të dy ligjeve, mirëpo nuk kanë dorëzuar ndonjë raport. Gjatë kësaj periudhe është mbajtur së paku një takim në muaj, mirëpo nga procesverbalet e publikuar në faqen e Kuvendit të Kosovës, nuk vërehet se është diskutuar në lidhje me monitorimin e zbatimit të këtij ligji. Komisioni ka dështuar që të kryejë punën e tij. Nevoja që të ketë një raport të detajuar të monitorimit të zbatimit të këtij ligji është e madhe, pasi është ka mundësuar krijimin e një situatë paradoksale, ku nuk është arritur qëllimi i ligjit. Qeveria ka rritur të hyrat, infektimet nuk janë ndalur dhe qytetarët kanë blerë vetë barnat për trajtimin e infektimit.

⁵⁷ Periudha llogaritet, data ose muaji kur janë dorëzuar ofertat

⁵⁸ Kuvendi i Republikës së Kosovës. Procesverbal i takimit të Komisionit për Shëndetësi mbajtur më 24.05.2021 Proc_nr_03_dt_24_05_2021_KSh_pUf8kdKGUE.pdf (kuvendikosoves.org)

⁵⁹ Kuvendi i Republikës së Kosovës. Procesverbal i takimit të Komisionit për Shëndetësi mbajtur më 31.05.2021 https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc_nr_04_dt_31_05_2021_KSh_9SNDECd2vB.pdf



Rekomandime

Në bazë të analizës së më sipërme, KDI u drejton institucioneve publike rekomandimet si në vijim:

- 1 SHSKUK të mbledhë informacione nga të gjitha njësitë e saj në lidhje me sasinë e produkteve që nevojiten të blihen gjatë vitit 2023, dhe të përgatisë një Plan të detajuar të Prokurimit e që do t'i shërbente menaxhimit më efikas të furnizimeve edhe shpenzimeve.
- 2 SHSKUK-së të publikojë Njoftimin Paraprak për secilin aktivitet të prokurimit nëse është qëllimi që të shkurtohet afati kohor dhe ai të publikohet së paku 40 ditë më herët se Njoftimi për Kontratë.
- 3 Ministria e Shëndetësisë dhe SHSKUK, konform obligimeve ligjore nga ligji për pandeminë, të krijojë mekanizma për rimbursimin e qytetarëve të cilët janë detyruar të blejnë barnat privatisht në mungesë të stokut publik.
- 4 Komisioni për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 të dorëzojë raportin e monitorimit në një afat sa më të shpejtë pasi ka kaluar gati një vit e gjysmë prej ku ky komision është themeluar.
- 1 Ministria e Shëndetësisë, SHSKUK dhe të gjithë akterët e përfshirë në menaxhimin e situatave emergjente duhet të krijojnë mekanizma që mundësojnë bashkëpunim më të mirë ndërinstytucional dhe ndarje të qartë të përgjegjësisë në mënyrë që të evitohen vendimet kundërtënëse dhe situatat emergjente të menaxhohen në mënyrë më të përgjegjshme e më efikase.
- 6 Duke qenë se kredia e marrë nga BB do të paguhet nga buxheti publik, respektivisht tatim paguesit e Kosovës, MSH duhet të publikojë të gjitha kontratat që nënshkruhen përmes UNOPS në uebfaqen e saj.
- 7 Ministria e Shëndetësisë të kërkojë llogari nga UNOPS për blerjet/kontratat me çmimet e larta.
- 8 Zyra Kombëtare e Auditimit të auditoj performancën e kontratës së ndërlidhur ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe UNOPS.
- 9 SHSKUK dhe MSH të komunikojnë mes vete më shpesh në mënyrë që kërkesat e dosjes së tenderit sa i përket Autorizim Marketingut të jenë të njëjta.



